



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2022
Nr. Dok. 202200299/1

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Korçë*

Drejtuar: **Z. Admir ABRIJA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Altin GUSHO
Drejtor i I.E.V.P-së

KORÇË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në neni 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe nenin 81 të ligjit 81/2020, "Për trajtimin dhe të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu inspektimin periodik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Korçë.

Inspektimi u krye në datë 07.03.2022 sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin, Komisioneria e MKPT Ermonela Xhafa si dhe nd/komisionerët pranë Mekanizmit Kombëtar znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu, z. Hazbi Selita, dhe z. Adil Skuqi me detyrë nd/komisioner i Seksionit të Veçantë¹.

Objektivi kryesor i inspektimit në I.E.V.P. Korçë ishte vlerësimi i kushteve infrastrukture që garantojnë sigurinë, jetesën, shëndetin dhe zhvillimin e aktiviteteve rekreative për të burgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim

¹ Më datën 14.04.2022 kuvendi ka vendosur në detyrën e Komisionerit të Mekanizmit Kombëtar z. Ahmet Prenci.

rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre; trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim; kontrolli dhe administrimi i dokumentacionit që evidenton punën e kryer sipas sektorëve; si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm².

Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë gjetjet e inspektimit dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Vizita inspektuese periodike e Mekanizmit Kombëtar në I.E.V.P. Korçë për vitin 2022, u zhvillua në bazë të metodologjisë së inspektimit në burgje. Grupi i inspektimit zhvilloi paraprakisht një takim informues me Drejtorin e komanduar z. Fation Fasho³ si dhe shefin e sektorit të çështjeve shoqërore, shefin e policisë dhe përgjegjësit e sektorëve, të cilët u njohën me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, stafi i institucionit informuan në lidhje me masat e marra për garantimin e të drejtave dhe trajtimin e të burgosurve në këtë institucion, plotësimin e kushteve të jetesës në dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme.

Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 329, datë 15.01.2009, "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë është kategorizuar si burg i sigurisë së lartë, me një seksion të sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi. Kapaciteti i institucionit sipas faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është parashikuar për **312** persona. Institucioni dhe ka ambiente observimi, qendër spitalore, objekte kulti dhe ambiente të tjera edukuese. Kategoria e të dënuarve të moshës 18-21 vjeç (gjithsej 17 të paraburgosur) ishin të integruar në një nga sektorët e paraburgimit dhe ishin të akomoduar në dhoma më vete nga të paraburgosurit e tjerë. Orari i ajrimit dhe aktivitetet e tjera me karakter këshillimor dhe edukativ me këtë kategori, zhvilloheshin në orare më vete nga grup moshat e tjera të të dënuarve.

Në datën e zhvillimit të inspektimit, në institucion ndodheshin **441 nga të cilët 241 të paraburgosur 145 të dënuar me vendim të formës së prerë, siguria e zakonshme dhe 55 të dënuar siguri e lartë.**

² Shkresë nr.K4/I43-2 prot., datë 16.12.2021 "Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në IEVP Korçë".

³ Drejtori I I.E.V.P Drenovë vazhdon në detyrë z. Altin Gusho.

Grupi i inspektimit verifikoi situatën e popullimit në I.E.V.P. Korçë edhe për periudhën e fundit 6 mujore, ku nga informacioni rezultoi si më poshtë vijon:

- Shtator 2021 470 të dënuar 158 persona mbikapacitet
- Tetor 2021 460 të dënuar 148 persona mbikapacitet
- Nëntor 2021 452 të dënuar 140 persona mbikapacitet
- Dhjetor 2021 451 të dënuar 139 persona mbikapacitet
- Janar 2022 447 të dënuar 135 persona mbikapacitet
- Shkurt 2022 445 të dënuar 133 persona mbikapacitet
- Mars 2022 449 të dënuar 137 persona mbikapacitet

I.E.V.P. Korçë rezulton të ketë mbipopullim të vazhdueshëm, referuar kjo dhe inspektimit të Avokatit të Popullit për vitin 2021 ku rezultoi që ky institucion kishte mbipopullim⁴ prej 152 personash. E njëjta situatë mbipopullimi u konstatua edhe përgjatë inspektimit në muajin mars 2022 nga Avokati i Popullit me një mbipopullim prej 129 personash. Tejkalimi i normës prej 4m² hapësirë jetike për person, e cila konsiderohet si shkelje e standardit të sipërfaqes së banimit për person, si dhe trajtim degradues e jo njerëzor. Shkelja e këtij standardi është evidentuar nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitave monitoruese në Shqipëri, i cili në përfundim të vizitës ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare se: “Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”.

Ambientet në I.E.V.P. Drenovë paraqiteshin si më poshtë:

-Seksioni i sigurisë së lartë kishte 4 (katër) sektorë me një total prej 34 dhomash dhe 68 shtretër, si dhe 4 klasa dhe 4 magazina.

-Seksioni i paraburgimit kishte 4 sektorë me një total prej 34 dhomash dhe 164 shtretër, si dhe 4 klasa dhe 4 magazina.

-Seksioni i sigurisë së zakonshme kishte një total prej 44 dhomash dhe 257 shtretër, si dhe 4 klasa dhe 4 magazina.

-Sektori i observimit kishte 6 dhoma dhe 12 shtretër.

-Sektori i izolimit kishte 10 dhoma dhe 10 shtretër.

Në total I.E.V.P. Korçë dispononte 531 shtretër.

⁴ Mbipopullimi në I.E.V.P Drenovë nga inspektimet e Avokatit të Popullit rezulton përgjatë viteve 2019, 2020, 2021.

Bazuar në Urdhrin nr.43, datë 25.03.2021 të Kryeministrit të Shqipërisë, **struktura dhe organika** e I.E.V.P. Drenovë ka në përbërje:

- 32 pozicione pune punonjës civil,
- 232 punonjës me status police, nga të cilët 15 janë punonjës të rolit të mesëm dhe 217 janë punonjës të rolit bazë.

Në total organika përbëhet nga 264 punonjës.

Nga komunikimi me stafin drejtues të institucionit dhe administrimi i dokumentacionit konstatoam se mungesat në organikë janë: Në sektorin civil 5 pozicione të lira pune: zv/drejtor, specialist i burimeve njerëzore, kuzhinier, pastrues, specialist i çështjeve shoqërore. Në sektorin Policor 33 vende të lira pune dhe punonjës të rolit të mesëm mungesa 6-të, në pozicionet: shef policie, specialist i regjimit të brendshëm, specialist i regjimit të jashtëm, specialist policie dhe analist risku, specialist informacioni 2 punonjës. Punonjës të rolit bazë 27 mungesa, gjithashtu dhe 9 punonjës policie të pezulluar, çka përbën 15% të numrit të përgjithshëm të stafit këto mungesa janë problematike nëse do të marrim në konsideratë që në këtë I.E.V.P ka 20% mbipopullim.

Sipas të dhënave, që u morën gjatë kësaj vizite, nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se disa nga rekomandimet e Avokatit të Popullit kanë gjetur pjesërisht zbatim:

- **Ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin në 24 orë në ditë dhe përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm në I.E.V.P. Korçë.
- **Ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në I.E.V.P, Korçë sipas kontratës tre paleshe me ISKSH dhe depot farmaceutike.
- **Ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin me materialet e nevojshme dentare për ofrimin e një shërbimi të plotë stomatologjik.
- **Ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e sektorit shëndetësor me regjistrin për evidentimin e rasteve të dhunës.
- **Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi** për marrjen e masave për riparimet e nevojshme të ambienteve të dusheve në I.E.V.P. Korçë.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit, një vit më parë nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar, më konkretisht:

- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave për uljen e mbipopullimit në I.E.V.P Drenovë.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të institucionit me kohë të plotë me 2 mjekë të përgjithshëm
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin me ngrohje të përshtatshme të dhomave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në I.E.V.P. Korçë për t’iu përshtatur kushteve klimaterike.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave për plotësimin e organikës së punonjësve të policisë të rolit bazë.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si dhe aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e higjienës në tualetet e dhomave të banimit të paraburgosurve/dënuarve.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave për të përmirësuar cilësinë dhe larmishmërinë e ushqimit në I.E.V.P. Korçë në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve, duke shmangur shpërdorimin e tij në vijim.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave për mbikëqyrjen e vazhdueshme të veprimtarisë të njësisë tregtare në I.E.V.P, Korçë për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Avokati i Popullit vëren me shqetësi se edhe disa rekomandime që nuk lidhen me fonde buxhetore apo vendimmarrje në instanca më të larta shtetërore nuk janë zbatuar e për këtë kërkon marrjen e masave të mëtejshme.

Trajtimi

Grupi i inspektimit të MKPT-së, zhvilloi intervista konfidenciale individuale dhe në grup me të dënuar, pa praninë e punonjësve të policisë, me qëllim mbledhjen e informacionit në lidhje me garantimin e të drejtave dhe trajtimit të personave që vuajnë dënimin në këtë institucion.

Intervistimi i të dënuarve u fokusua në çështjet kryesore që kishin të bënin me plotësimin e kushteve të jetesës; identifikimin e rasteve të përdorimit të dhunës apo përdorimin e forcës fizike nga punonjësit e sigurisë tej kufijve të parashikuar në aktet normative, si dhe aktet ndërkombëtare; funksionimi i sistemit për zgjidhjen e

kërkesë/ankesave të të burgosurve; procedurat që ndiqen nga komisionet e ngritura me urdhër të drejtorit të institucionit si komisioni i pritjes, komisioni i dhënies së masave disiplinore, komisioni për verifikimin e çmimeve të mallrave dhe ushqimeve që tregtohen nga njëzia tregtare që ndodhet në këtë institucion, në raport me çmimet e tregut; llojet e aktiviteteve që ishin zhvilluar kryesisht gjatë periudhës së pandemisë; trajtimi shëndetësor i të dënuarve; cilësia e gatimit të ushqimit; furnizimi sipas normativave me detergjente dhe mjetet e higjienës personale etj.

Nga intervistat e zhvilluara me të burgosurit, për periudhën e inspektimit, grupi i monitorimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkalim të forcës nga ana e personelit të sigurisë në këtë institucion. Raporti dhe marrëdhëniet e stafit të institucionit dhe punonjësve të policisë me të dënuarit, kanë qenë korrekte dhe në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Gjatë intervistave u konstatua se, ankesat më të shumta në numër kishin të bënin me kufizimin e takimeve fizike me familjarët e tyre (një takim në muaj), moslejimin e takimeve të zgjatura për të dënuarit që janë familjarë, si dhe mungesën e dhënies të lejeve shpërblyese, pavarësisht përmirësimit në tërësi të situatës së pandemisë dhe lehtësimit të masave shtrënguese. Ata kërkonin nga DPB-ja kalimin në regjimin e zakonshëm për 4 takime fizike me familjet e tyre, ndërsa komunikimi online të ngelet si opsion për ata të dënuar që kanë familjet jashtë shtetit, për arsye se, situata e pandemisë mundet të vazhdojë për një kohë të gjatë dhe nuk është e ligjshme që kjo e drejtë t'ju mohohet të burgosurve për një periudhë pa afat. Në vijim të këtij shqetësimi, të dënuarit ngritën si problematikë kërkesën e administratës së burgut, që në takimet fizike, duhet që dhe fëmijët të jenë të pajisur me tampon të konfirmuar “negativ”. Ky test duhet të kryhet në laboratorë privat, pasi nuk kryhet nga ambulancat shtetërore, duke rritur në këtë mënyrë shpenzimet e familjeve të tyre. Sipas informacionit të sektorit shëndetësor të institucionit, kjo masë është vendosur me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në zbatim të akteve normativave për këtë qëllim, që lejon zhvillimin e një takimi në muaj, si dhe kërkesat që duhet të plotësojnë të dënuarit dhe familjarët e tyre, për zhvillimin e këtij takimi.

Një problematikë e ngritur në intervistat me të dënuarit, kishte të bënte me mungesën e larmishmërisë së menisë ushqimore, si dhe cilësia e keqe e bukës. Të dënuarit pretendonin se për shkak të tyre, ata ishin të detyruar të merrnin ushqime nga familjarët e tyre dhe të gatuanin brenda në ambientet e banimit. Gjithashtu ankesa kishte për sigurimin e ngrohjes në I.E.V.P Korçë, për t'iu përshtatur kushteve klimaterike nisur edhe nga fakti që rajoni i qarkut të Korçës karakterizohej nga temperatura të ftohta gjatë vitit.

Masat mbrojtëse

Grupi i monitorimit, kërkoi informacion në lidhje me procedurat që ndiqen nga Komisionit i Pritjes të të paraburgosurve në institucion, Komisioni Disiplinor për

dhënien e masave disiplinore, si dhe për mënyrën e plotësimit të regjistrave dhe dosjeve psiko-sociale të të dënuarve. Nga informacioni dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga stafi i institucionit, u konstatua se në I.E.V.P. në Drenovë zbatohen me korrektësi procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, në lidhje me funksionimin e komisioneve për pranimin e të burgosurve në institucion, dhënien e masave disiplinore, si dhe përditësimin e formularit për vlerësimin e sjelljes së të dënuarve.

Nga punonjësit e institucionit, u informuam dhe për mënyrën e plotësimit të kartelës personale elektronike, e cila përditësohet nga punonjësit e sektorëve sipas fushave që mbulojnë, kartelë e cila e shoqëron të burgosurin gjatë gjithë kohës së qëndrimit në I.E.V.P, pavarësisht transferimeve që mund të ndodhin me të burgosurin nga njëri institucion në tjetrin.

Kontaktet me jashtë regjimit

Komunikimi me telefon me familjarët kryhej 8 herë në muaj nëpërmjet telefonave me kartë, të cilët ishin të instaluar në mjedisin e regjimit të brendshëm. Të dënuarit ngritën në mënyrë të përsëritur shqetësimin për uljen e minutave të bisedës në kartat telefonike, nga 120 min në 60 min kohë bisede, ndërkohë që çmimi i kartave ka mbetur i njëjtë nga kompania private e miratuar për ofrimin e këtij shërbimi. Nga verifikimi i aparateve telefonik me kartë u konstatua se, të dënuarit nuk mund të lidheshin me numrin e telefonit të Avokatit të Popullit (pa pagesë), i cili gjithashtu ky numër nuk duhet të jetë i përfshirë në listën e telefonave të të dënuarve të miratuar për komunikim me familjarët e tyre. Më Datën 11.04.2022 u botua në Fletoren Zyrtare nr.55 miratimi i rregullores së përgjithshme të burgjeve në të cilën është përcaktuar qartë se⁵: I burgosuri mund të komunikojë në telefon me Avokatin e Popullit pa pagesë dhe në çdo kohë, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve. Numrat e telefonit të Avokatit të Popullit nuk përfshihen në listën e numrave të telefonit, të miratuar për çdo të burgosur.

Ndërkohë, takimet me familjarët vijonin të kryheshin 4 herë në muaj, nga të cilët 3 ishin takime online nëpërmjet gjashtë kompjuterave që ishin instaluar në ambientin e takimeve.

Sipas informacionit të shefit të policisë në këtë institucion, sistemi i monitorimit të ambienteve me kamera ishte pjesërisht funksional dhe nga inspektimi u konstatua se gjendja e sistemit të monitorimit ishte: Kamera me skemë sigurie gjithsej janë 63 copë. Kamera të vendosura gjatë periudhës 2010 deri më 2022 janë 9 copë, pra gjithsej janë 72 kamera.

⁵<https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/55/b6ea8c36-795f-4d2c-9c00-d4ebdc450691>.

Kamera rrotulluese janë vendosur 8 copë, 7 në murin rrethues dhe një në postbllok. Nga 8 kamera rrotulluese vetëm një prej tyre është funksionale. Kamera nr.8 e cila mbulon ambientin e ajrimit tek sektori i sigurisë së lartë punon me luhatje, kamera nr.9 e cila mbulon ambientin e ajrimit të sigurisë së zakonshme gjatë orëve të natës nuk punon. Institucioni i Avokatit të Popullit edhe më herët ka kërkuar përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes me kamera por duket që problemi vazhdon. Administrimi i rrjetit kryhej nga specialisti i IT-së së institucionit.

Të paraburgosurit ishin në seksion më vete nga të dënuarit. Ata realizonin ajrimin dhe aktivitetet e tjera të përbashkëta veçmas nga të dënuarit.

I.E.V.P. Korçë ishte krijuar një mjedis i veçantë për të paraburgosurit/dënuarit, që kishin fëmijë të vegjël lidhur me ushtrimin e të drejtës së prindërimit në distancë.

Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të dënuarit/paraburgosurit qëndronin ulur, duke patur kontakt fizik me fëmijët e tyre. Gjatë takimeve respektohej privatësia. Gjithashtu, në këtë institucion kishte edhe 2 dhoma për takime speciale të të dënuarve me bashkëshortet apo bashkëjetueset e tyre.

I.E.V.P. Korçë kishte disa të dënuar, që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj.

Deri në muajin Tetor 2021, të burgosurit kishin nxitje për t'u punësuar në I.E.V.P, pasi përfitonin ulje dënimi për punën e kryer bazuar në Dekretin Nr. 7298, datë 08.04.1989 të Presidiumit të Kuvendit Popullor. Kjo praktikë është ndërprerë me hyrjen në fuqi të VKM Nr.602, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*, ku parashikohet vetëm shpërblimi me pagë e të burgosurit të punësuar, si nga subjektet private ashtu edhe nga vetë I.E.V.P-ja, sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve dhe shumës së përcaktuar në këtë VKM.

Aktualisht të burgosurit e punësuar në I.E.V.P. Korçë nuk përfitojnë as ulje dënimi dhe as shpërblim në të holla.

Pas hyrjes në fuqi të VKM Nr.602, datë 13.10.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i ka kërkuar IEVP Korçë të paraqesi sugjerime lidhur me organikën e të punësuarve. IEVP-ja ka sugjeruar një organikë me 46 persona.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka shkurtuar organikën e punës duke miratuar vetëm 28 të punësuar. Nga kjo organikë, I.E.V.P-ja ka bërë një riorganizim të vendeve të punës sipas nevojave.

I.E.V.P-së nuk i është vënë në dispozicion ndonjë model i kontratës së punës që do të lidhet me të burgosurit dhe as buxhet për pagesën që ata do të përfitojnë.

Ky problem është regjistruar me iniciativë nga Seksioni i Veçantë pranë Avokatit të Popullit dhe ka nisur hetimi administrative lidhur me zbatimin e VKM Nr.602, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*, por në lidhje me këtë inspektim

rezulton se miratimi i V.K.M.-së nuk e ka përmirësuar situatën por e ka Përkeqësuar atë.

Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve parashikohet në nenet 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në nenin 44 të ligjit të cituar më sipër parashikohet se: 1. I burgosuri ka të drejtën e një shpërblimi mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. 2. I burgosuri ka të drejtë të disponojë lirshëm dyzet për qind të të ardhurave të fituara nga puna.”

Së fundmi, me miratimin e Vendimit nr. 602, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj” , i cili është botuar në F.Z. nr. 161, datë 15.10.2021, pritet edhe zgjidhja e kësaj problematike.

Grupi inspektimit i kushtoi rëndësi dhe verifikimit të afishimit të posterave me të drejtat e të burgosurve, të cilat ndodheshin në ambientet e korridoreve të dhomave të banimit dhe ambientet e përbashkëta si klasat, bibliotekat etj. U evidentua se, ato janë të afishuara në ambientet e regjimit të brendshëm, por ato kanë nevojë të rifreskohen me postera të rinj. Gjithashtu, në vende të aksesueshme për të dënuarit, ishin afishuar edhe numrat e telefonit të Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH), si dhe OJF-ve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Kushtet materiale

Grupi i inspektimit verifikoi në vend gjendjen e kushteve infrastrukturore në regjimin e brendshëm, kryesisht në dhomat e banimit, dhomat e veçimit dhe dhomat e observimit, si dhe plotësimin e kushteve materiale që shërbejnë për një jetesë normale të të dënuarve, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 32 dhe 33 (Kushtet e jetesës në institucion) të ligjit nr.81/2020, ku mes të tjerave thuhet se: *“Mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes respektojnë dinjitetin njerëzor dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit”.*

Grupi inspektues, në fokus të vizitës së tij pati edhe monitorimin e kushteve materiale, të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. I.E.V.P. Korçë është një institucion i vënë në funksion gjatë vitit 2008. Infrastruktura e përgjithshme e institucionit ishte e mirë me ndarje të rregullta të godinave dhe ofronte funksionalitet në lëvizje dhe në elementë të sigurisë.

Në dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve, u vu re disa prej dhomave edhe hapësira ishte e kufizuar për shkak të mbipopullimit në sektorin e paraburgimit, në disa dhoma **kishte të paraburgosur që flinin në dysheme me dyshek**. Nga ana e tyre

u informuam se kapaciteti zyrtar duke u bazuar në numrin e shtretërve për të paraburgosurit është 202, ndërkohë që në ditën e inspektimit në I.E.V.P. Korçë ishin të akomoduar 241 të paraburgosur.

Theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës shprehet se norma minimum e hapësirës për person, në institucione të tilla, është 6m² për dhomat për një person dhe 4m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës.

Ndërkohë edhe çështja e ngrohjes së ambienteve për shkak të kushteve klimaterike kishte problematikë lidhur me oraret. Fakti që, edhe nga inspektimet e mëhershme në këtë institucion, kjo situatë ishte evidentuar si problematike dhe nisur dhe nga mungesa e investimit të dukshëm në këtë drejtim konstatohet se çështja e ngrohjes do të jetë sërisht një moment delikat për nevojë ndërhyrjeje me qëllimin e krijimit të kushteve sa më të favorshme në shërbim të të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Dushet ndodheshin në çdo seksion, përjashtuar ambientin e parashikuar për observim. Në ambientet e dusheve kishte lavamanë dhe katër ose pesë dushe, ky ambient kishte nevojë për ndërhyrje në mirëmbajtja edhe riparime. Nga intervistat që u bënë me të burgosurit, në të gjitha sektorët, u pohua se dushi realizohej përgjithësisht dy herë në javë. Nga grupi i inspektimit u konstatua se ambientet e paraburgimit kishin nevojë për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lysterjen e dhomave.

Cilësia e ujit në I.E.V.P. Korçë ishte e mirë dhe furnizimi me ujë nuk kishte probleme. Furnizimi me ujë kryhej përmes lidhjes me rrjetin e ujësjellësit të qytetit. Grupi i inspektimit u informua nga zv.titullari i institucionit se në mënyrë periodike ishin kryer analizat e ujit dhe si përfundim ishte vlerësuar se **uji nuk ishte i pijshëm** në këtë institucion. Furnizimi me ujë të pijshëm është e drejtë themelore e njeriut dhe për personat e dënuar është një element parësor për trajtimin e tyre me dinjitet.

Në ambientet e takimeve, gjendeshin 7 sportele xhami të mirëmbajtura, ambiente të përcaktuara për takimet me familjarët të të dënuarve dhe paraburgosurve.

Në I.E.V.P. Korçë ekzistonte një godinë e cila shërbente si spitali i këtij institucioni. Në katin e parë të tij gjendej dhoma e stomatologut, dhoma e vizitave të mjekut, si dhe farmacia. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige dhe sterilizues. Dhoma e mjekut dhe farmacia ishin të lyera dhe të mirëmbajtura. Ndërsa në katin e dytë ishin 8 dhoma me shtretër. Në spital ndodheshin banjat me dy tualete dhe një post dushi.

Seksioni i sigurisë së zakonshme ishte i vendosur në godinën B. Kjo godinë ishte e përbërë nga dy kate, me nga katër sektorë për çdo kat. Gjate inspektimit u konstatua se nëpër dhoma ishin akomoduar 4-5 persona, në maksimum të kapacitetit. Ky rast përbën shkelje të standardit ligjor lidhur me sipërfaqen dhe kubaturën e banimit për një person, në kundërshtim dhe me rekomandimet e bëra nga CPT për Shqipërinë.

Seksioni i sigurisë së lartë I.E.V.P. Korçë ishte i vendosur në sektorin A. Ky seksion ishte i ndarë në 4 sektorë për të dënuar me siguri të lartë, dhe 4 sektorë për të paraburgosur siguri e lartë. Kryesisht kati i parë i sektorit të të dënuarve kishte një shpërndarje nëpër dhoma me nga një të dënuar. Dhomat ishin të pajisura me tualete brenda.

Sektori i observimit I.E.V.P. Korçë kishte 6 dhoma dhe 12 shtretër. Në këtë sektor gjendeshin 2(dy) tualete të përbashkëta për të gjitha dhomat. Problematike ishte çështja e kryerjes së dusheve jashtë kësaj godine, dhe se nuk kishte hapësirë për ajrosje. Në ditën e inspektimit në këto ambiente ndodheshin 28 persona. Këto dhoma nuk plotësojnë standartin e parashikuar në rregullore.

Në sektorin e izolimit kishte 10 dhoma të pajisura me tualete brenda. Ky seksion kishte ambient ajrimi.

Në I.E.V.P. Korçë kishte palestra, klasa dhe dhoma këshillimi. Gjithashtu kishte një sallë kompjuterësh e pajisur me 6 kompjutera të cilët ishin në gjendje funksionale në periudhën e pandemisë dhe në vazhdim për komunikimin me familjarët nëpërmjet platformës skype. Palesttrat ishin pajisur me mjete të sjella nga vetë të dënuarit. Aktivitetet sportive konsistonin kryesisht në futboll, volejboll dhe lojëra tavoline siç janë lojëra me letra dhe domino. Ambienti i kultit ishte i bollshëm, i ndriçuar dhe i mirëpajisur.

Kuzhina e institucionit ishte e madhe dhe ambienti në të paraqitej me higjienë të mirë. Kishte edhe 2 paradhoma ku njëra shërbente si magazinë për ushqimet dhe një tjetër për larjen e enëve. Kuzhina funksiononte në kushte normale pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyja ditore ishte e afishuar. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë.

Megjithatë të dënuarit dhe të paraburgosurit shfaqën ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit i cili nuk kishte larmishmëri. U evidentua se një masë e madhe e të burgosurve dhe të paraburgosurve në I.E.V.P. Korçë nuk e konsumonin ushqimin e

përgatitur në institucion, duke shpërdoruar një pjesë të konsiderueshme të tij. Mjaft të dënuar kanë pohuar se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë.

Në I.E.V.P. kishte lavanderi, ku gjendeshin dy lavatriçe por për shkak të fluksit të madh dhe kërkesës për këtë shërbim nuk arrihej të plotësoheshin nevojat e të gjithë të dënuarve dhe të paraburgosurve. Për përsa i përket larjes së rrobave të fjetjes ato vazhdonin të laheshin nga familjarët në pjesën më të madhe të rasteve ose nga vetë të dënuarit brenda ambienteve të tyre.

Gjithashtu kryesisht çarçafët dhe batanijet e të dënuarve dhe të paraburgosurve, pothuajse për të gjithë sektorët, ishin sjellë nga familjarët pasi institucioni nuk u vendoste në dispozicion çarçafë, por vetëm batanije.

Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi dhe aktiviteti i të dënuarve në I.E.V.P. ishte i parashikuar në orarin e veprimeve ditore të miratuar nga drejtori i institucionit. Sektori i çështjeve shoqërore kishte programe mujore për zhvillimin e aktiviteteve me të dënuarit në bazë sektori, me grupe të dënuarish, si dhe për këshillime individuale.

Përsa i përket aktiviteteve me pjesëmarrjen e gjerë të të dënuarve, për shkak të respektimit të masave anti-COVID 19, ato ende nuk ishin lejuar. Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta nga të cilat mund të përfitonin të dënuarit/paraburgosurit të cilat ishin kryesisht lojërat e tavolinës siç janë lojëra me letra dhe domino dhe ndeshjet e futbollit dhe volejbollit me numër të ulët pjesëmarrësish. Në I.E.V.P. Korçë ka rifilluar procesin arsimor për të dënuarit në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Drejtësisë për shtrirjen e shkollës 9-vjeçare në institucionet penitenciare. Procesin mësimor ndiqet nga 35 të dënuar dhe në këtë institucion zhvillojnë mësimin dy mësues përkatësisht për klasat 1 deri 5 dhe klasat 6 deri 9.

Ajrimi ditor zgjaste mbi 3 (tre) orë sipas rregullores dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive.

Trajnime profesionale në I.E.V.P. Korçë zhvilloheshin pasi në këtë njësi administrative kishte shërbime të tilla të ofruara nga Qendra Rajonale e Formimit Profesional në Korçë. Për të dënuarit sapo kishte përfunduar kursi për berber dhe kishin përfituar certifikim 10 të dënuar. Ndërkohë u informuam nga përgjegjësi i sektorit social se ishin në pritje të rifillimit të kurseve të reja.

Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nga siguria që ata kishin dhe aktivitetet e zhvilluara, gjithashtu konsistonin edhe në festa me rastin e datave të rëndësishme ose festive fetare. Në ambientin e kultit në orën 12:00-13:00 mbledheshin praktikuesit e fesë myslimanë dhe praktikonin ritet e tyre fetare. Ndërsa të martën, të enjten dhe të shtunën mbledheshin praktikuesit e fesë ortodokse nën drejtimin e një të dërguari nga kisha e Korçës. Gjithashtu në ambientin e kultit praktikonin ritet e tyre edhe besimtarët protestantë.

Librat që gjendeshin në inventarin e bibliotekës vireshin në dispozicion të paraburgosurve apo të dënuarve për lexim sipas kërkesave. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat. Biblioteka e institucionit ishte funksionale dhe dispononte 1000 tituj me libra. Një nga të dënuarit ishte i punësuar në biblioteka, i cili e mirëmbante atë dhe plotësonte kartelat për çdo të dënuar që kishte interes për leximin e librave.

Salla e kompjuterëve përdorej për organizimin e temave ndryshme nga sektori psiko-social, kryesisht me të miturit. Në këtë institucion kishte 2 mësues të cilët mbulonin procesin arsimor çdo ditë të javës.

Për sa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta në raport me numrin e personave dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale dhe këshillime në klasa. Sipas stafit të institucionit të paraburgosurit dhe të dënuarit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato.

Sa i takon veprimtarive rikrijuese, u vërejt se në I.E.V.P. Korçë ato që zhvilloheshin më së shumti ishin lojërat e tavolinës, pasi personat mund të luajnë edhe në dhomën e tyre, ose edhe në ambientet e ajrimit (*lojëra me letra, domino dhe shah*).

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato ishin të plotësuara relativisht mirë me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë. Në dosjet ishin përfshirë si programet individuale të trajtimit ashtu dhe vlerësimet periodike.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, aktivitetet me të dënuarit nuk duhen të ndërpriten, pasi një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është ri-integrimi në shoqëri i këtyre personave, në momentin kur ata do të lenë burgun. Lidhur me këtë qëllim, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se: *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁶.

⁶Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>.

Në vijim të këtij rekomandimi, institucioni ynë thekson nevojën që sektori psiko-social të hartojë programe këshillimi për trajtimin individual të këtyre personave sipas grup moshave, të ndërthurura me zhvillimin e aktivitete me grupe të vogla personash, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet te këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive, gjatë periudhës së pandemisë.

Ajrimi i të dënuarve realizohej sipas orarit ditor, por në mënyrën që janë të organizuara godinat në regjimin e brendshëm të institucionit, të dënuarit qëndronin në ajrim edhe jashtë këtij orari. Në regjimin e brendshëm ndodheshin 4 bokse ajrimi (çdo sektor më vete) dhe një fushë futboll, ku lejoheshin të zhvilloheshin aktivitete sportive me grupe të vogla të dënuarish.

Stafi i sektorit të çështjeve shoqërore i institucionit ka 7 punonjës në organikë, nga të cilët 6 punonjës social dhe një shef sektori. Aktualisht, në stafin e këtij sektori mungon 1 punonjës social.

Nga dokumentacioni i administruar nga grupi inspektues rezultoi se, sektori i çështjeve shoqërore kishte plan vjetor dhe mujor për zhvillimin e aktiviteteve me të burgosurit të ndarë më vete për moshat 18-21 vjeçar dhe për grup moshat e tjera.

Shërbimi shëndetësor

Gjatë vizitës në I.E.V.P. Korçë si dhe nga intervistat me të dënuarit, problematika u konstatuan lidhur me shërbimin shëndetësor. Ankesat konsistojnë kryesisht në vonesat e medikamenteve, të cilat shpesh mbulohehin me kontributet e sjella nga familja për efekt shpejtësie.

Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte për të dënuarit, dhe për të paraburgosurit, si rrjedhojë e plotësimit të dokumentacionit të dosjeve personale, për të bërë të mundur sigurimin e ilaçeve.

Ndërsa, për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai funksiononte, si rrjedhojë e pasjes së bazës materiale. Dhe uniti dentar punonte normalisht.

Personeli i kujdesit mjekësor në I.E.V.P. Korçë përbëhej nga 2 (dy) mjekë me kohë të pjesshme (1 mjek psikiatër dhe 1 mjek i përgjithshëm) 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog me kohë të pjesshme dhe 5 (pesë) infermier nga të cilët 2 prej tyre ishin në mungesë.

Mjekët në institucion ishin të punësuar me kontratë me kohë të pjesshme 4 orë çdo ditë pune, ndërsa personeli tjetër shëndetësor ishte me kohë të plotë. Duke qenë se,

I.E.V.P. Korçë është një nga institucionet më të mëdha të sistemit peniteciar në Shqipëri, është e nevojshme plotësimi i menjëhershëm i organikës me mjek me kohë të plotë, si dhe për trajtimin akut të personave me probleme të shëndetit mendor, duhet të shtohet organika dhe me një mjek psikiatër. Aktualisht, vizitat mjekësore të specializuara të pacientëve të sëmurë kronikë, trajtimi i rasteve emergjente, si dhe atyre me probleme të shëndetit mendor, kryhen pranë Spitalit Rajonal Korçë.

Skema e furnizimit me ilaçet të rimbursuara për të sëmurët kronikë, funksiononte rregullisht. Por, në intervistat me të burgosurit të sëmurë kronikë, ata ngritën si shqetësim mungesën në listën e rimbursimeve të medikamenteve që përdorshin nga ana e tyre dhe në këto kushte ato mbuloheshin me kontributet e sjellja nga familjarët. Ndërsa, furnizimi me medikamente për sëmundje patologjike dhe në rastet e urgjencave, nuk mungonte. Farmacisti i institucionit, furnizohej me medikamente rregullisht 2 herë në vit nga DPB dhe sipas nevojave urgjente, me blerje nga fondet e institucionit. Në çdo rast, shpërndarja e ilaçeve të të sëmurëve bëhej nga personeli i infermierëve sipas turneve, por gjithmonë sipas rekomandimit të mjekut të institucionit.

Nga verifikimi i afatit të përdorimit të medikamenteve në farmaci, nuk rezultuan ilaçe të skaduar, por është e nevojshme unifikimi i praktikës për nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre ilaçeve që u ka kaluar afati i përdorimit, në zbatim edhe të rekomandimit të KLSH-së, për auditimin e këtij sektori për vitin 2021.

Përsa i përket shërbimit stomatologjik, ai kishte filluar të funksiononte së fundmi si rezultat i plotësimit të bazës materiale.

Dhoma e mjekut, farmacistit dhe dhoma e urgjencave ishin të kompletuara me të gjitha orenditë dhe pajisjet e nevojshme, që nevojiten për ndjekjen e protokollit shëndetësor si për të sëmurët kronikë ashtu edhe në përballimin e rasteve të urgjencave.

Funksionimi i sistemit shëndetësor në këtë institucion, në përgjithësi është në standardet e përcaktuara në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*⁷.

⁷ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Aktualisht, në IEVP Korçë u evidentuan të sëmurë që vuanin nga probleme të shëndetit mendor, gjithsej 16 persona , përdorues të lëndëve narkotike që trajtohen me metadon 12 persona dhe të dënuarve të diagnostikuar me sëmundjen e diabetit 19 persona.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash themeltar, regjistri i të sëmurëve kronike, si dhe regjistri për konsultat që mbahen jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull, po ashtu edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve.

Në përfundim të vizitës, grupi i inspektimit zhvilloi një takim me drejtuesin e komanduar dhe stafin e këtij institucioni, me të cilin u biseduan problematikat e konstatuara gjatë inspektimit dhe intervistat me të burgosurit, për të cilat drejtuesi i këtij institucioni i vlerësoi dhe u angazhua se, në bashkëpunim me stafin do të ndërmerren masat e menjëhershme për t'i zgjidhur çështjet që i përkisnin detyrave dhe përgjegjësive të tyre institucionale, të ngarkuar me ligj.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e mbipopullimit si një problem i vazhdueshëm në këtë institucion, si dhe transferimin e personave në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ku ka hapësira të mjaftueshme dhe të pa shfrytëzuara.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në sektorin e paraburgimit, ku disa nga të paraburgosurit , në disa dhoma flinin në dysheme me dyshek në kushte çnjerëzore dhe degraduese.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të institucionit me 2 mjekë me kohë të plotë, për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të të

dënuarve/paraburgosurve për vizita mjekësore dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor, sa më cilësor.

4. Të merren masat e menjëhershme dhe të nevojshme, për plotësimin e strukturës organike: Në sektorin civil me 5 pozicione të lira pune: zv/drejtor, specialist i burimeve njerëzore, kuzhinier, pastrues, Specialist i çështjeve shoqërore dhe në sektorin policor 33 vende të lira pune.
5. Të merren masat e nevojshme, për vijimin e procedurave të punës për ndryshimin e Urdhrit të përbashkët nr.104/5 prot. datë 19.06.2006 të Ministrit të Drejtësisë dhe nr.205/5 datë 27.07.2006 të Ministrit të Shëndetësisë “*Përmirësimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit*”, me qëllim përmirësimin e kuotave ushqimore dhe larmisë së menysë së ushqimit për të burgosurit.
6. Të merren masa për organizimin e punës të stafit juridik dhe sektorit të çështjeve shoqërore, për shtimin e kontakteve të përditshme dhe informimin e të dënuarve, mbi ecurinë e procesit të zgjidhjes së kërkesë-ankesave të tyre, si dhe me qëllim rritjen e efikasitetit për përmirësimin e sistemit të kërkesë-ankesave në institucion.
7. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin e numrit të kamerave të sigurisë në ambientet e brendshme të institucionit, kryesisht në ato ambiente që nuk mbulohen nga kamerat ekzistuese të sigurisë, me qëllim parandalimin e veprimeve të kundraligjshme ndaj të dënuarve.
8. Marrjen e masave të menjëhershme nga DPB-ja për transferimin e personave të dënuar që ndodhen në dhomat e observimit tej afateve ligjor, në një institucion tjetër, për shkak të mospërshtatjes së tyre në sektorët e këtij institucioni.
9. Të merren masa të menjëhershme, për planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve social-kulturore me pjesëmarrjen masive të të dënuarve, që shërbejnë rehabilitimit dhe kalimit të kohës së lirë, për të dënuarit.
10. Të merren masa të menjëhershme, për zbatimin e VKM-së për shpërbllimin financiar të të punësuarve për punën e kryer, që nga hyrja në fuqi e këtij akti nënligjor.
11. Të merren masa të menjëhershme, për rifreskimin e posterave me të drejtat e të burgosurve me postera të rinj dhe vendosjen e tyre në vende të aksesueshme prej tyre.

12. Të merren masa e të evidentohen shkaqet dhe eventualisht përgjegjësitë për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI